

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	GJKKO gjobit avokatët që vijojnë bojkotin e seancave për celularët
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/21/gjkkko-gjobit-avokatet-qe-vijojne-bojkotin-e-seancave-per-celularet/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:53:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	21 shtator 2026, 11:02:47 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a8adfb7f3839c270565bbf9a74039bbdae55255538d658fe257f4341075026f3
TEKSTI	148decab9114f3ff5d0f8d28b0299a8a74d1c5eeda483caefb894da0afb863bf
PAMJA	242d33c1dc560a3bd82ebd3a9637a4a7b562a4bc1dd917e0a827615ef71bdb36

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8a912b2443feac75225aec203ef537cfd0c00eb044514f7c14447e48ae629fbb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8a912b2443feac75225aec203ef537cfd0c00eb044514f7c14447e48ae629fbb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TEMA:

BELINDA BALLUKU

ERION VELIAJ

VETING

SPAK

MJEDISI

EDI RAMA

SALI BERISHA

ZGJEDHJE 2025

Kryefaqja Lajme

GJKKO gjobit avokatët që vijnë bojkotin e seancave për celularët

Pasi Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë nuk pranoi kërkesën e avokatëve për ndryshimin e rregullores së brendshme, lidhur me përcaktimin e ri që ndalon telefonin celular në sallat e gjykim, filloi ndëshkimin financiar të përfaqësuesve ligjorë të të pandehurve të cilët bojkotojnë seancat, nismë që u mor nga Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës së Avokatisë dy javë më parë, pa afat.

nga Edmond Hoxhaj — 2 days më parë në Lajme Koha e leximit: 2 min lexim

AA 0



Hyrja e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, SPAK. | Foto: LSA

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë caktoi të hënën më 21 shtator masa ndëshkuese financiare ndaj avokatëve të cilët bojkotojnë seancat e caktuara për t'u zhvilluar në këtë gjykatë, për arsye të përcaktimeve në rregulloren e brendshme të re, që nuk lejon përdorimin e telefonave celularë.

Rregullorja, e miratuar më 17 korrik dhe që hyri në fuqi më 1 shtator, vendos një sërë rregullash të reja për sigurinë dhe sjelljen në ambientet e Gjykatës. Një pjesë e dispozitave prekin drejtpërdrejt aksesin dhe punën e avokatëve të të pandehurve, si dhe të gazetarëve që raportojnë mbi proceset gjyqësore.

Me argumentin se telefoni celular është një mjet pune, Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës së Avokatisë vendosi bojkotin pa afat të të gjitha proceseve gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë. Përveç masave të sigurimit, të zëvendësimit të tyre, shuarjeve apo masave të dënimit që janë në procesin e amnistisë.

Prej asaj dite, seancat publike të të gjithë çështjeve penale të caktuara për t'u zhvilluar në GJKKO, nuk janë realizuar për shkak të bojkotit të avokatëve.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, GJKKO ju përgjigj me shkrim më datë 16 shtator avokatëve për kërkesën e tyre për rishikim të rregullores, duke vërejtur se nuk bie ndesh me Konventën CETS për mbrojtjen e profesionit të avokatit. Po ashtu, GJKKO konstatoi se kontestimi nuk e pezullon rregulloren, ndërsa shtoi se avokatët kanë gjithë mundësitë që të ndjekin rrugët ligjore për ta kundërshtuar.

Të hënën, në seancën e caktuar për t'u zhvilluar në orën 09:00, me të pandehur Emiljano Shullazi, Viktor Ymeri, Luftar Reçi dhe të tjerë të akuzuar për vrasjen e Vajdin Lamajt dhe Artan Arsit në vitin 2005, trupi gjyqësor i kryesuar nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, caktoi gjoba ndaj mbrojtësve të të pandehurve. Megjithatë avokatët gjendeshin në sallë, ata qëndruan në vendet e rezervuara për publikun, duke bërë me dije se vijnë të jenë në bojkot. Gjykata caktoi masa ndëshkuese financiare për 15 avokatët e zgjedhur dhe të caktuar kryesisht në këtë çështje, nga 5 mijë lekë për secilin.

Përveç avokatëve, edhe gazetarët kundërshtojnë rregulloren e GJKKO. Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë. AGSH depozitoi një iavë më parë në Givkatën Kushtetuese një

Kuvendi injoron konsultimet publike, fut në shqyrtim Reformën Territoriale

16:11 | 23/09/2026

Avokati i Netanyahu-t mes drejtuesve të kompanisë që prodhon dronë izraelitë në Serbi

15:08 | 23/09/2026

Eurodeputetja i kërkon qeverisë që të mos zvarrisë ndryshimet në ligjin 21/2024

14:26 | 23/09/2026

A mund të ndjekim Hungarinë në hetimin e pasurive të zyrtarëve?

12:20 | 23/09/2026

Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë

06:20 | 23/09/2026

Rama shkarkon Hysenin, por shmang përgjegjësitë për skandalin në SHISH

16:31 | 22/09/2026

kërkesë për shfuqizimin e disa pikave të kësaj rregulloreje, duke i cilësuar ato si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

AGSH kërkon shfuqizimin e atyre pjesëve që vlerëson se cenojnë lirinë e medias, publicitetin e procesit gjyqësor, aksesin e publikut dhe autonominë editoriale, si dhe pezullimin e tyre deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.

Reporter.al

Opinion

Reportazhe

Analiza

Investigime

Lajme

Blog

Rajoni

Rreth nesh

Stafi

Kontaktimi

Ankesa dhe Korrigjime

Politika e privatësisë dhe
rregulla të tjera

Letra për redaktorin

Follow Us



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN

Dev by [Slida.PRO](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.